



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
ZËDHËNËSI

Tiranë, më 02/8 / 2014

Njoftim për Shtyp

KLSH KALLËZON NË PROKURORI PESË ZYRTARË TË BASHKISË URA
VAJGURORE

Kanë kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme gjatë ushtrimit të detyrës si anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), por dhe Juristit të Njesisë së Prokurimit (NJP) në kryerjen e procedurave të prokurimit publik, të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës dhe moszbatim të ligjit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit financiar nr. 371/1 datë 03.4.2014, ka audituar Bashkinë Ura Vajgurore për periudhën Janar 2012- Dhjetor 2013.

Nga ky auditim, u konstatuan një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore, për të cilat KLSH ka kryer kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, për R.SH., Nënkryetare e Bashkisë dhe në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), I.B., në cilësinë e Kryetarit të KVO, V.M., në cilësinë e anëtarit të KVO, N. XH., në cilësinë e anëtarit të KVO dhe E.Gj.. në cilësinë e Juristit dhe anëtarit të Njesisë së Prokurimit Publik, për konsumim të elementëve të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, neni 248 i Kodit Penal, për prokurimin me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane” *pasi*:

Edhe pse është kryer katër herë procedura e prokurimit nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është lidhur kontratë me shoqërinë e cili plotësonte kriteret për tu shpallur fituese, por pastrimi i qytetit është kryer me tre shtesa kontratash të lidhura me tjetër shoqëri, veprim në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 9643 datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” (LPP) dhe pikën 5/b të Kreu IV të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Procedura e katërt, rezulton se nga KVO është kualifikuar e shpallur fitues një OE i cili nuk përmbushte kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga NJP dhe janë skualifikuar dy OE të cilët i përmbushnin kriteret për tu shpallur fitues.

Nga KVO janë skualifikuar padrejtësisht dy Operatorë Ekonomik (OE) për mungesë dokumentacioni, kur në fakt plotësojnë kërkesat dhe specifikimet sipas dokumentet standarde. Skualifikimi i OE është në kundërshtim me nenin 2, 45, 46 dhe 47, të LPP.

Nuk kanë zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 54/3 datë 14.02.2013, për të lidhur kontratën e shërbimit me OE i cili plotësonte kërkesat për tu shpallur fitues, madje ka zhvilluar një tjetër procedurë prokurimi me objekt: “Marrje me qira të mjetit teknologjik” veprime në kundërshtim me nenin 64 të LPP.

Edhe pse ka kryer më parë një procedurë prokurimi, ka realizuar pastrimin duke nënshkruar kontratën e shërbimit me një tjetër operator ekonomik pa kryer asnjë lloj procedure prokurimi, në kundërshtim me LPP.

Veprimet dhe mosveprimet, që janë shoqëruar me kualifikime e kualifikime të gabuara të kryera nga Autoriteti Kontraktor, janë të papajtueshme me kriteret e veçanta të kualifikimit në tenderëve, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe pikën 1 "Përgjegjësia e autoritetit kontraktor" të Kreu – t të parë të VKM nr. 1, datë 10.1.2007.

Për veprimet e mësipërme, KLSH i janë përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse, përmes kallëzimeve për shpërdorim detyre për pesë punonjësit, prej të cilëve dy janë me funksione drejtuese dhe tre në nivel specialistësh.

Gjithashtu, KLSH i ka kërkuar Kryetarit të Bashkisë Ura Vajgurore, fillimin e procedurave administrative e ligjore për marrjen e masës disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënieve të punës" për 4 nëpunës të cilët janë aktualisht në marrëdhënie pune me këtë njësi vendore.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT